

Vllazëria Shen Kseni

«Sherbimi për lirimin e të burgosurve pa te ardhura
edhe te denuarve në mungesë»

T.Θ 10147, 54110 Selanik
HELLAS

Datë

«Perendia dergoi birin saj tek njerëzit...
qe të shpetojnë ata nëpermjet Tij»
(Ioan 3,17)



I dashuri ynë z.....

Për sa kohë ndodheshe në burg, të kujtonim me dashuri dhe luteshim për ty. Edhe sepse ti ke shtetësi e kombësi tjetër.

Krishti na mesoi ti duam njerëzit e të gjitha kombeve, pa perjashtim. Bile, ashtu sic e ka shpallur dhe Apostull Pavli në vitin 52 pas Krishtit nga Arios Pagos e Athinës se «**Perëndia krijoi prej një giaku çiftin protoplast dhe prej tij të gjitha kombet e njerëzimit qe të banojnë në të gjithë ruzullin tokësor, caktoi gjithashtu për sejcilin komb sa kohë do të egzistojnë, por edhe kufijt e banimit të tyre» (Veprat 17, 26).**

Në këtë menyrë të gjithë njerëzit jeni vëllezer midis nesh, si krijesa e njerës dhe të vetmes Perëndi, ndaj duhet të duam njëritjetrin. Akoma dhe kur njëriu ynë është armiku ynë personal, dhe rastisi të na bëjë keq me njerën ose me tjetren menyrë. Në nje nga vizitat tona në burgjet e Greqisë, nje prind Christian Orthodox erdhi bashkë me ne duke mbajtur një pako më shumë dhurata për të burgosurin që i kishte vrarë birin e tij në aksident automobilistik. Nuk të ben pershtypje kjo? Ky prind beri ate qe thotë Krishti yne: «**Duajini armiqët tuaj**» (Llukai 6, 27).

Keshtu edhe Krishti ynë na do te gjithë njerëzit njësoj. Kjo, nuk tregon se Ai pranon padrejtësitë qe bëjne njerëzit ne dashje ose pa dashje. Krishti i do të gjithë njerëzit, por kundershton padrejtësitë e tyre. Tekstualisht, njesoj sic ben nje mjek. Simpatizon të semurin e tij mjeku, por kundërshton semundjen e tij. Dhe Krishti dashurinë e tij e tregoi jo vetem tek homoetniket e tij d. m. th. judaiket, por edhe tek eteroetniket.

Shëmbuj:

Shëmbulli i parë është gruaja nga Hananea.

Krishti tregoi gjithmone po atë dashuri për nje nenë eteroetnike nga Finiqi, gruan nga Hananea. Bile, Finiqi ishte vend armiqësor ndaj Izraelit. Por duke iu pergjigjur lutjes së kesaj gruaje, i sheroi vajzen. (Mattheu 15, 21-28).

Shëmbulli i dytë është Romaku ekatondark (udhëheqes i njeqind burrave):

Krishti tregoi dashurinë e tij edhe tek ekatondarku Romak, personalitet i Kapernaumit. Duke in përgjigjur edhe ketu thirjes se tij te ngrohtë: shero sherbetorin tend të semurë (Mattheu 8, 5-13).

Shëmbulli i tretë gruaja Samarite.

Edhe ketu Krishti tregon te njejtën dashuri. Ketu, tek gruaja Samarite, qe e takoi ne pusin (burimin) e Iakovit. Si njeri Krishti ishte judaik. Dhe Judaiket jo vetem nuk flisnin me Samaritet, por silleshin dhe armiqësish midis tyre. Dhe megjithatë Krishti bashkëbisedoi me gruan Samarite. (Joan 4, 5-42). Gruaja Samarite besoi tek Krishti,urrejti mëkaten e saj dhe u be ierapostull (Apostull i shenjt) i Krishtit. Kaloi në shumë vende duke shpallur Ungjillin e Krishtit. Me se fundi arriti ne Rome. Këtu mundi te kristianizoj Domninën, bijen e perandorit Nerona, i cilli ishte ndjekës i egër i kristianeve. Prandaj, asnje nuk është i huaj, as per Krishtin dhe as për te kristianet. Asnje nuk eshte armik. Të gjithë njerëzit jemi femijet e Perëndisë dhe vellezer midis nesh.

Keshtu te sillnim ndermend përsa kohë ishe në burg. **Si femijë të Perëndisë. Si vellain tonë.** Dhe kur drejtori i burgut kërkoi ndihmen tonë ekonomike, ne menjëherë derguam sasinë e kërkuar të paravë, për të shpejtuar keshtu lirimin tend. Nuk mundonim të benim ndryshe, përderisa Zoti ynë perputh veten e Tij me sejçillin prej te burgosurve dhe thotë: «**Në burg isha dhe erdhet pranë meje**» dhe «**përderisa vepruat në këtë menyrë ndaj vellezerve te mij, tek mua e vepruat**» (Mattheu 25, 36-40).

Ja, përsë shlyem borxhin tend dhe tani je i lirë të kthehesh në atdheun tend, në shtepinë tende, tek njerëzit e tu, me bekimin e Shumërespektuarit Mitropolitit tonë z. z. **Nikodhimi**.

Perendia jonë të të mbroje nga cdo rrezik dhe të bokojë kthimin tend në vendin dhe në shtëpinë tende, dhe te kujtosh gjithmonë dashurinë që Ai na frymëzoi për ty dhe gjithë bashkenjerëzit tanë.



Me urime zemre dhe dashurinë e Krishtit
Për «**Sherbimin per lirimin e të burgosurve pa te ardhura**
Dhe te denuarve në mungesë»

Arhimandriti Jervasios Ioannis Raptopoulos
Ierokirikas (shpallës i fjalës së shenjtë në kishë).